



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic Of Kosovo
Komuna Shtime
Opstina Štimlje / Municipality Of Shtime



Nr. 01/55
Data, 10.03.2021

Në mbështetje të: Nenit 5, Paragrafit 1.2 i Nenit 6, Paragrafi 1.2 i Nenit 8, Nenit 15, Paragrafi 1 i Nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien Në Shfrytëzim Dhe Këmbimin E Pronës Së Paluajtshme Të Komunës, Të Nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për Përcaktimin E Procedurave Të Dhënies Në Shfrytëzim Dhe Këmbim Të Pronës Së Paluajtshme Të Komunës, Të Vendimin e Kuvendit Komunal Nr. 01-060/01-23082/20-01/273 të datës 16.11.2020 Për Miratim Paraprak Të Pronës Së Paluajtshme Komunale, Vendimin e Kuvendit Komunal Nr.01-060/01-24960/20-01/313 të datës 11.12.2020 për Zgjedhjen e Komisionit Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Pronën e Paluajtshme Komunale në Zonën Kadastrale Dugë.
Komisionit Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Pronën e Paluajtshme Komunale në Zonën Kadastrale Dugë shpall:

NJOFTIM PUBLIK
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM

1	Emërtimi, lokacioni, përshkrimi, sipërfaqja, destinimi dhe pronësia e parcelave	Pronat e miratuara nga kuvendi për dhënie në shfrytëzim janë: 1. Pjes e Parcelës. Lokacioni zona kadastrale Dugë te vendi i quajtur Kodra e Mustabashit. Kultura është kullos e klasës së pestë. Certifikata në pronësi të Kuvendit Komunal me Nr. P-72809029-00230-0 me sipërfaqe prej 35231m². Destinimi për zhvillimin e turizmit, agroturizmit. 2. Parcelë. Lokacioni zona kadastrale Dugë te vendi i quajtur Ahishte për mbi Shpi. Kultura është kullos e klasës së pestë. Certifikata në pronësi të Kuvendit Komunal me Nr. P-72809029-00251-0 me sipërfaqe prej 3859m². Destinimi për zhvillimin e turizmit, agroturizmit.
2	Kohëzgjatja e shfrytëzimit dhe kufizimet për aplikim	- Dhënie në shfrytëzim, deri në afat prej 99 vjet (nëntëdhjetenëntë), me kompensim për shfrytëzim, me pëlqim të pronarit dhe në pajtim me ligjin në fuqi. - Konkurrimi lejohet për një, disa apo të gjitha parcelat.

3	Çfarëdo kushti apo kufizimi mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim	- Fillimi i aktiviteteve brenda 6 muajve dhe përfundimi i investimeve kapitale si dhe fillimi i veprimtarisë brenda 2 viteve. - Punësimi sipas planit të biznesit - Investime sipas planit të biznesit - Shfrytëzuesi nuk ka drejtë në asnjë mënyrë që ngastrën kadastrale të marrë në shfrytëzim ta bart te personi i tretë me nën qira apo në çfarëdo mënyre tjetër në të kundërtën, themeluesi e ka të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës pa paralajmërim. - Shfrytëzuesi nuk ka drejtë në asnjë mënyrë që ngastrën kadastrale të marrë në shfrytëzim ta len në hipotekë në të kundërtën, themeluesi e ka të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës pa paralajmërim. - Shfrytëzuesi nuk ka të drejt ta ndërroj veprimtarin e biznesit me të cilën ka aplikuar në të kundërtën, themeluesi e ka të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës pa paralajmërim.
4	Veprimtarit që nuk lejohen të ushtrohen në këto parcela	Në parcelat e ofruara për shfrytëzim nuk lejohen të zhvillohen veprimtari afariste si: - Lojëra të fatit; Autoserviset; - Prodhimin e gëlqeres; - Sharra për lëndë drunore; - Mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave ku magazinohen mbeturina interne (plastik, letër, dhe qelq);
5	Formën e konkurrimit	Me shprehje të interesit
6	Çmimi fillestar	1€ ari për vit (nga data e nënshkrimit të kontratës, pagesa hyn në fuqi).
7	Kriteret për pjesëmarrje në konkurrim	- Numri i të punësuarve mbi 5 - Vlera e investimeve kapitale mbi 100000 euro - Fillimi i veprimtarisë brenda 2 viteve - 70% e të punësuarve duhet të jenë qytetarë të Komunës së Shtimes
8	Procedurat e regjistrimit të ofertuesve	Ofertuesit mund të aplikojnë nga data e publikimit për 15 ditë kalendarike. Aplikacioni merret në zyrës për shërbim të qytetarëve në objektin e komunës dhe mund ta shkarkoni në ueb faqen e komunë. Po ashtu konkursin mund ta gjeni në ueb-faqen zyrtare: http://kk.rks-gov.net/shtime në linkun Shpalljet - Konkursset ku edhe mund ta shkarkoni. Aplikimi bëhet në zyrën për shërbim të qytetarëve në objektin e komunës jo më larg se data e fundit për aplikim. Oferta duhet të jetë në zarf të mbyllur me të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim.

9	Afati i fundit për aplikim	Afati i fundit për aplikim është me datë 24.03.2021 në ora 16:00
10	Koha dhe Vendi ku mbahet hapja e ofertave	Hapja e ofertave mbahet më datën 25.03.2021 në ora 09:00, Ndërtesa e Komunës, Kati 1, Salla e Vogël e Kuvendit Komunal.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- Aplikacioni
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Plani i biznesit i cili duhet të përmbajë: Fillimi i aktiviteteve brenda 6 muajve, numrin e punëtorëve, vlerën e investimit dhe llojin e veprimtarisë që do ta ushtroj po ashtu datën e fillimit të veprimtarisë (jo më shumë se 2 vite). Historianin e biznesit (nëse është ekzistues) si dhe veprimtarin biznesore.
- Deklaratë në emrin e aplikuesit në të cilën deklaron ofertën për qiranë vjetore për ari (jo më pak se 1€).
- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve të tatimit në pronë.
- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve ndaj ATK-së (nuk vlen për bizneset fillestar)
- Dëshmi nga ATK për numrin aktual të punësuarve

Kriteret për zgjedhjen e ofertave:

- Vlera e investimit
- Numri i të punësuarve nga investimi
- Lloji i investimit që është interes publik për komunën
- Përfitimi financiar i komunës
- Krite të tjera që janë të parapara në këtë njoftim.

Pjesëmarrëseve në konkurrim u garantohej e drejta që:

- Të informohen me procedurat e shprehjes së interesit;
- Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

Anëtarët e Komisionit:

Valentina Halili Ferati _____ Arben Lami _____

Adelina Veseli _____ Imer Pershani _____



Adresa: Rr. "Tahir Sinani" Nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.